



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 1119/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania e Sigurimeve S... me seli në Zvicër, përfaqësuar nga Shoqëria e Avokatëve “ICS ASSISTANCE” L.L.C, Besnik Nikqi, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Kompania e Sigurimeve “E...” me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.625/2021 të datës 08.11.2021 të Përmbartuesit Privat Eset Murati, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 27.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Kompania e Sigurimeve “E...”, i paraqitur kundër urdhrit përmbartimor P.nr.625/2021 të datës 08.11.2021 të Përmbartuesit Privat Eset Murati.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.625/2021 i datës 08.11.2021 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Eset Murati.
- III. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim t’ia paguaj kreditorit shumën prej 624.00 € (gjashtëqind e njëzet e katër euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Eset Murati, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania e Sigurimeve S... me seli në Zvicër, përfaqësuar nga ICS Assistance L.L.C, në bazë të titullit ekzekutiv – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamentit për Çështje Ekonomike III EK.nr.292/20 të datës 26.03.2021 ka nxjerr urdhrin P.nr.625/2021 me datën

08.11.2021, me të cilin ka caktuar zbatimin e përmbarimit, ndaj debitorit Kompania e Sigurimeve “Eurosig”, me seli në Prishtinë duke e detyruar debitorin që të ua bartë shumën prej 33,466.77 euro në emër të borxhit kryesor - respektivisht rimbursimit, me kamatë vjetore sipas lartësisë së mjeteve të deponuara në bankë për një vit, duke filluar prej datës 26.09.2012 e deri në datën e përlllogaritjes nga eksperti financiar, shumën prej 8,387.85 euro në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, shumën prej 624.00 euro në emër të përpilimit të propozimit për ekzekutim si dhe në emër të shpenzimeve përmbarimore shumën sipas tarifës së përmbaruesit privat, respektivisht pas llogaritjes së kamatëvonesës së ekspertit financiar shumën e përgjithshme që do të vlerësohet, ta bartë në xhirollogarinë bankare Nr. .... të të autorizuarit te kreditorit, pranë bankës komerciale N... .

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se e kundërshton në tërësi pretendimin e kreditorit si të paqëndrueshëm juridikisht për arsye se kërkesa nga dokumenti përmbarues është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve, duke theksuar se për shkak të shkeljeve të bëra nga ana e dy instancave ka shumë pritshmëri se vendimi i Gjykatës Supreme do të jetë në favor të saj dhe duke marrë parasysh që Gjykata Supreme duhet të vendosë për disa shkelje esenciale që janë bërë nga ana e gjykatës, i ka propozuar gjykatës që të shtyj përmbarimin deri në pranimin e vendimit nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit, në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ndër të tjera ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe se të njëjtat janë të pabazuara dhe pretendimi i debitorit se ndaj aktgjykimit sipas të cilit është iniciuar propozimi është paraqitur revizion pranë Gjykatës Supreme, nuk qëndron pasi që në rastin konkret nuk mund të jetë pengesë për përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë, sipas nenit 213 të LPK –së. Ka shtuar se kundërshtimi ka qëllim prolongimin e përmbarimit të detyrimit, andaj i ka propozuar Gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit të datës 17.11.2021 si të pabazuar, duke i kërkuar edhe shpenzimet për përgjigje në prapësim në shumën prej 624.00 Euro sipas tarifës të odës së avokatëve.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës,

duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Gjykata erdhi në përfundim se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, për faktin se në prapësimin e debitorit nuk janë dhënë arsye që prapësimi të pranohet si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbartimor, ndërsa e ka lënë në fuqi Urdhrin e Përmbartuesit Privat P.nr. 625/2021 të datës 08.11.2021, pasi që i njëjti është lejuar në bazë të dokumentit përmbartues (titullit ekzekutiv) – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike III Ek.nr.292/2020 i datës 26.03.2021, aktgjykim i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 16.10.2021 dhe i ekzekutueshëm nga data 28.10.2021.

Sipas dokumentit përmbartues (titullit ekzekutiv) – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike III EK.nr.292/20 debitori është detyruar që kreditorit të i paguaj në emër të shpërblimit të dëmit në emër të regresit për shpenzimet e trajtimit mjekësor dhe kompensimin për paafësi për punë gjatë mjekimit të siguruarës së paditësit për aksidentin e datës 10.03.2021 shumën e përgjithshëm prej 33,466.70 euro me kamatë sipas lartësisë vjetore në bazë të mjeteve të deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar, nga data 26.09.2012 e deri në pagesën definitive në afatin parativ prej 7 ditësh, duke llogaritur nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë. Si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 8.387.85 euro.

Gjykata gjeti se dokumenti përmbartimor i lartcekur është dorëzuar në origjinal dhe i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së, i cili përcakton se: *“Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit– vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbartimi, objekti i përmbartimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit”*.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbaues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbauesin vetëm në bazë të dokumentit përmbaues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.1, përcaktohen dokumentet përmbauese siç janë: *“vendimi përmbaues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbauese;”*, ndërsa me nenin 23. par.1 përcaktohet se *“ vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësor konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit.”*, dhe nenin 24 par. 1 përcaktohet të LPP-së përcaktohet se: *“Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbaueshëm po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po që se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.”*, ndërsa me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përmbaues është i përshtatshëm për përmbauesin në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se urdhri për përmbauesin i caktuar mbi bazën e titullit ekzekutiv – Aktgjykimit i plotëson kushtet për tu paraqitur si dokument përmbaues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbauesit, ngase janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.1, nenit 23 par.1, nenit 24 par. 1 dhe nenit 27 të LPP-së, pasi që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për Çështje Ekonomike III Ek.nr. 292/2020 i datës 26.03.2021 është i përmbaueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbauesin, pasi që në të janë treguar palët përkatësisht kreditorët dhe debitori, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se i njëjti lidhur me këtë çështje juridike, ka parashtruar revizion në Gjykatën Supreme, dhe kërkon shtyrjen e përmbauesit deri në vendosje sipas revizionit nga ana e Gjykatës Supreme, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është i pa bazuar pasi që debitori nuk e ka argumentuar me asnjë provë se zbatimi i përmbauesit do t'i shkaktojë atij dëm të pariparueshëm e po ashtu duke u bazuar në dispozitën e nenit 213 të LPK-së, me të cilën është përcaktuar se: *“Revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përmbauesin e aktgjykimit të*

*formës së prerë të goditur*”, rezulton se paraqitja e revizionit si mjet i jashtëzakonshëm juridik, nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktgjykimit të formës së prerë.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 par.4 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim dhe atë në shumën prej 624.00 € (gjashtëqind e njëzet e katër euro), siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifën e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE - Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1119/22, datë 27.09.2022

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi

palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve

nga dita e pranimit të aktvendimit, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes kësaj dhome.